



REPUBLIKA E KOSOVËS – KOSOVA CUMHURIYETI
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

MAMUŠA BELEDIYESI -- KOMUNA E MAMUSHËS
OPŠTINA MAMUŠA – MUNICIPALITY OF MAMUŠA



Me 30.11.2023

Mamushë

Në bazë të nenit 62 dhe nenit 26 paragrafi 1 të Ligjit për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 si dhe nenit 43 paragrafi 43.5 pika (b) të Rregullores për Prokurimin Publik 001/2022 bie këtë :

V E N D I M

I

Anulohet aktiviteti i prokurimit me nr. 626-23-12501-1-3-6 dhe nr. të brendshëm 626-23-030-1-3-6

II

I njëjti duhet të rishpallet sipas procedurave të prokurimit, pas afatit për ankesa.

III

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij.

A R S Y E T I M

Zyra e Prokurimit e Autoritetit Kontraktues - Komuna e Mamushës, me datë 13.11.2023 ka shpallur njoftimin për kontratë me titull: “FURNIZIMI DHE MONTIMI I TABELËS INFORMUESE NË OBJEKTIN E RI TË QKMF-s NË MAMUSHË” me nr. të prokurimit 626-23-12501-1-3-6 dhe nr. të brendshëm: 626-23-030-1-3-6. Pas njoftimit për kontratë, dosjen e tenderit e kanë shkarkuar njëzetë (20) Operatorë Ekonomik, ndërsa tenderin e ka dorëzuar vetëm një (1) prej tyre i cili i ka plotësuar kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë. Mirëpo pas kërkesës tonë drejtuar Operatorit Ekonomik pjesëmarrës për të dorëzuar dokumentet e përshtatshëm të kërkuara në nenin III.1 të dosjes së tenderit paragrafët 2 dhe 3 të cilat janë kërkuar për O.E. të cilët rekomandohen për kontratë, pasi që me tenderin e tyre nuk i kanë dorëzuar dokumentet e lartcekura i njëjti nuk i ka dorëzuar dëshmitë e kërkuara në afatin e paraparë në kërkesë, andaj tenderi i është refuzuar si i pa përgjegjshëm.

Në rastet kur pas hapjes së tenderit vërtetohet se Autoriteti Kontraktues nuk ka pranuar asnjë ofertë të përgjegjshme, kërkohet që të anulohet procedura e prokurimit në fjalë.

Andaj, duke u bazuar në atë që u tha më lartë, në dispozitat e nenit 62 të LPP-s si dhe nenit 43 paragrafi 43.5 pika (b) të Rregullores për Prokurimin Publik 001/2022 u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Gazmend Gashi
Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Mamushës

